



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 2162, datë 21.09.2012

Për

“Shqyrtimin e ankimimit administrative të Albtelecom sh.a në lidhje me Aktin Administrativ, Vendimi nr. 2119, datë 04.07.2012 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcaktimin e Sipërmarrësit Albanian Mobile Communications sh.a me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Enkeleda Bega, në mbledhjen e datës 21.09.2012 sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimin e ankimit administrative të Albtelecom sh.a në lidhje me Aktin Administrativ, Vendimi nr. 2119 datë 04.07.2012 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcaktimin e Sipërmarrësit Albanian Mobile Communications sh.a me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”

BAZA LIGJORE:

1. Germa ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 9918*);
2. Pika 2 e nenit 137, neni 138 e vijues i ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*K.Pr.A*)
3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918; (*Rregullorja e Brendshme*);
4. “Rregullore nr. 9 “Per analizen e tregut”, miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues nr. 747, date 17.07.2009 (*Rregullorja*);
5. Rregullore per Aksesin dhe Interkoneksionin miratuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar (*Rregullorja*);

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa nr. 3944 prot, datë 06.08.2012 e Albtelecom sh.a (AKEP nr. 1664 prot, datë 06.08.2012) “Ankimi Administrativ” , plotësuar me shkresën nr.3944/2 prot., datë 4.09.2012, “Përgjigje tuajës nr.1665/1 prot, datë 27.08.2012 të “Kërkesë për plotësim dokumentacioni” (*Ankim Administrativë*);
2. Shkresë nr.1665/1 prot, datë 27.08.2012 të AKEP drejtuar Albtelecom-it me objekt “Kërkesë për plotësim dokumentacioni”;
3. Vendimi nr. 2119, datë 04.07.2012 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcaktimin e Sipërmarrësit Albanian Mobile Communications sh.a me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese” (*Vendimi*),
3. Projektvendim i KD te AKEP për “Shqyrtimin e ankimit administrative të Albtelecom sh.a në lidhje me Aktin Administrativë, Vendimi nr. 2119, datë 04.07.2012 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcaktimin e Sipërmarrësit Albanian Mobile Communications sh.a me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”, (*Projektvendimi*);
4. Relacion shpjegues mbi projektvendimin (*Relacioni*);
si dhe,
5. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R R E N:

1. Albtelecom me shkresë nr. 3944 prot, datë 06.08.2012 “Ankimi Administrativ” ka bërë ankim administrativ për ndryshimin e Aktit Administrativ Vendimit nr. 2119, datë 04.07.2012 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcaktimin e Sipërmarrësit Albanian Mobile Communications sh.a me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”;

2. AKEP-i duke konstatuar mungesën e dokumentacionit në mbështetje të ankimit, me shkresën nr.1665/1, datë 27.08.2012 i ka kërkuar Albtelecom që për të mbeshtetur pretendimet e ngritura të paraqesë prova shkresore që çënojnë sigurinë e biznesit, si dhe marrëveshjet ekzistuese të Albtelecom me operatorët bartës ndërkombëtarë, duke i bërë të ditur se do të fillonte shqyrtimin e ankimit administrativ pasi të plotësohej kërkesa ankimore edhe me këtë dokumentacion.
3. Albtelecom në përgjigje të shkresës nr.1665/1 prot, datë 27.08.2012 të AKEP, ka kthyer përgjigje me shkresën nr.3944/2 prot., datë 4.09.2012, duke përfshirë si dokumentacion:
 - a. Në cilësinë e provave shkresore që çënojnë sigurinë e biznesit të tij, Albtelecom ka përfshirë midis të tjerave:
 - i. Shkresa nr.5220, date 18.11.2010 për rivendosjen e ofrimit të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare me Vodafone;
 - ii. VKD nr.1436, datë 3.11.2010; VKD nr.1437, datë 3.11.2010 (Për ndryshime në vendimet e datës 23.07.2010);
 - iii. Shkresa nr.3904, datë 20.08.2010 (ankim administrativ per vendimet e datës 23.07.2010)
 - iv. Shkresa e AKEP nr.2297/31, datë 3.11.2010 (mbyllje e procedimit administrativ për mosmarrveshjen Albtelecom-AMC)
 - v. VKD nr.1435, datë 2.11.2010 (Vendim për mbyllje procedimi dhe Urdheri bashkangjitur per zbatimin e vendimit);
 - vi. Shkresa nr.4980, datë 1.11.2010 (ndërprerje në mënyrë të njënashme e trafikut ndërkombëtar nga AMC dhe Vodafone);
 - vii. Shkresa nr.4878 date 26.10.2010 (Rivendosje kapacitete interkoneksini me Vodafone);
 - viii. Shkresa 4765/3, date 26.10.2010 (Mosmarrveshje me Vodafone për tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare);
 - ix. Shkresa nr. 4696/1, date 25.10.2010 ne vijim te shkreses se mesipemrme
 - x. Shkresa e Vodafone për Albtelecom me ref CEO/0111/EXH, date 25.10.2010 (Pëergjigje mbi shkresën e Albtelecom nr.4565, datë 20.10.2010);
 - xi. Shkresa e AMC nr.4837, date 25.10.2010 (tarifa e terminimit e AMC për thirrjet ndërkombëtare);
 - xii. Shkresa nr.4696, date 15.10.2010 (shtim objekti për mosmarrveshje me AMC);

- xiii. Shkresa nr.2885/10, date 5.10.2010 (kërkesë për AKEP për shqyrtim ankimi të Albtelecom nr.2885/9, datë 20.09.2010)
- xiv. Shkresa nr.2885/8, datë 17.09.2010 (për zhbllokimin e qarqeve të interkoneksionit nga AMC);
- xv. Shkresa e AKEP nr.2885/5, datë 18.08.2010 (për rilidhjen e qarqeve të interkoneksionit AMC-Albtelecom).
- b. Marreveshje interkoneksioni të Albtelecom të lidhur me operatorë ndërkombëtarë;
- c. Marreveshje Interkoneksioni/Amendime te MI-ve me AMC dhe Vodafone, të cilat kanë reflektuar Vendimet e AKEP për ndryshim në ofertat referencë të operatorëve si dhe në mënyrën e përcaktimit të tarifës së terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare.
4. Albtelecom sh.a me anë të këtij ankimi administrativ kërkon ndryshimin e aktit administrativ duke shtuar pikën 6.5 në seksionin 6 të Vendimit nr. 2119, datë 04.07.2012 të KD të AKEP përmbajtjen si më poshtë:
- “Pavarësisht përcaktimeve të pikave 6.3, 6.4 më sipër Albanian Mobile Communications ka detyrimin të mos ndryshojë në mënyrë të njëanshme parimet, kushtet apo termat e ofrimit të shërbimeve të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare sipas marrëveshjeve komerciale të lidhura prej tij dhe efektive në datën e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi (Vendimi nr. 2119)”*
5. Albtelecom sh.a sqaron se, qëllimi kërkesës ankimore është plotësimi i këtij Vendimi me elementët të tillë sigurie dhe ofrimi të garancive që marrëveshjet dhe kushtet e termat e ofrimit të shërbimeve të nënshkuara me vullnet të lirë mes palëve të mos cënohen nga epërsia që i krijon ky Vendim operatorit Albanian Mobile Communications sh.a, duke rrezikuar krijimin e një tregu të mbyllur, deformim të konkurrencës dhe diskriminim të operatorëve në treg.
6. Albtelecom thekson se, ka gëzuar të drejtën dhe/ose detyrimin për ofrimin e shërbimit të tranzitimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe terminimin e këtyre thirrjeve në rrjetet celulare në çdo kohë në përputhje të plotë me detyrimet rregullatore, standartet, duke garantuar të gjithë treguesit e cilësisë, mbështetur në investimet e medha në infrastrukturë;
7. Albtelecom vlerëson se ne zbatim të detyrimeve të parashikuara në legjislacionin përkatës, si dhe ne Autorizimin e Përgjithshëm ka fituar një të drejtë e cila garantohet edhe nga Rregullore për “Akses dhe Interkoneksion” e cila në pikën 3 të nenit 6 parashikon se:
- “Operatori ofruar nuk mund të kufizojë Autorizimin e përgjithshëm të operatorit përfitues për të ofruar rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike nëpërmjet reduktimit të qëllimit të aksesit të ofruar”*
8. Cënimi i kësaj të drejte sipas Albtelecom, në kundërshtim me parimet kushtetuese dhe ligjore do të përbënte precedent të pasigurisë juridike dhe përkeqsim të situatës financiare së Albtelecom duke i hequr mundësinë për të konkuruar efektivisht në një treg të hapur;

9. Albtelekom kërkon që Albanian Mobile Communications sh.a të vijojë ofrimin e shërbimit të terminimit duke aplikuar për terminimin e trafikut ndërkombëtar tarifë të njëjtë me atë të trafikut kombëtar, duke mos e diferencuar atë në bazë të origjinës apo teknologjisë, dhe kjo tarifë duhet të jetë e orientuar në kosto.
10. Albtelecom vlerëson se këtë kërkesë e bazon në:
- Parimet e kuadrit rregullator, për orientimin e tarifave në kosto dhe detyrimin për mos diskriminim midis blerësve të ndryshëm, përfshirë segmentet e biznesit të tij për të njëjtin shërbim të ofruar;
 - Kuadrin rregullator dhe praktikën Europiane, duke sjellë në vëmendje dokumentin e komisionit evropian SEC(2010) 659, 1.06.2010 i cili shqyrton përvojën me analizat e tregjeve dhe masat rregulluese lidhur me terminimin e thirrjeve.
11. AKEP, bazuar në shqyrtimin e pretendimeve të ankimit administrativ të Albtelecom, në lidhje me Vendimin nr. 2119, datë 04.07.2010 të KD të AKEP, çmon se:
- a. AKEP në procesin e Analizës së Tregut celular, ka shqyrtuar ceshtjet në lidhje me terminimin e thirrjeve hyrese ndërkombëtare dhe vendimet e marra në lidhje me këtë ceshtje janë marrë pas një procesi konsultimi mbi dokumentin e analizes së tregut, analizë e cila në mënyrë të detajuar ka bërë trajtimin e trafikut ndërkombëtar hyrës, duke sjellë në vëmendje edhe historikun e tij në mënyrën e trajtimit dhe të vendimarrjeve në kohë të ndryshme për këtë shërbim.
 - b. Në trajtimin e rregullimit/derregullimit të marrëdhënieve midis operatorëve për thirrjet hyrëse ndërkombëtare, AKEP në procesin e Analizës së tregut celular mori në konsideratë një sërë faktorësh të tillë si:
 - i. faktin që terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare shërben si input për operatorët në vende të tjera (tregjet me pakice në këto vende) për të ofruar thirrje drejt abonentëve të këtij rrjeti, dhe se ai nuk është input për tregjet me pakicë të thirrjeve telefonike në Shqipëri;
 - ii. faktin që dis-balancat në kërkesë/ofertë për këtë shërbim dhe mos-përputhja e interesave komerciale midis palëve kanë çuar në probleme/rënie të cilësisë së shërbimit për përdoruesin fundor. Një fakt i tillë është i pakontestueshëm, pasi AKEP ka investuar në vijimësi për zgjidhje mos-marrëveshesh ndërmjet operatoreve tranzitues të trafikut ndërkombëtar hyrës dhe operatoreve që ofrojnë shërbimin e terminimit në rrjetet e tyre, ndaj të cilëve rëndon edhe përgjegjësia për cilësinë e shërbimit të ofruar pajtimtareve të rrjeteve të tyre.
 - iii. vlerësimi i faktit të rëndësishëm që në tregun e tranzitimit të trafikut ndërkombëtar nuk ka asnjë operator me fuqi të ndjeshme, dhe për rrjedhojë ofruesit e këtij shërbimi do të ishte e drejte dhe parimore, të shfrytëzojnë mundësitë që të ofrojnë hapësirat kontraktuale dhe liria ekonomike e tregut, gjë e cila nuk kushtezohet nga vendimarrjet e AKEP;

- iv. informacionin nga vendet e rajonit ne raportin e Mars 2012 te Cullen International¹, ku ne te gjitha vendet e rajonit tarifat e terminimit te thirrjeve nderkombetare percaktohen ne marrveshje konfidenciale dhe jane jashte rregulimit.
- c. Duke patur parasysh percaktimin ligjor sipas pikes 1 te nenit 42 te ligjit nr. 9918 sipas te cilit:
- “AKEP-i vendos ndaj sipermarrësve me fuqi të ndjeshme në treg detyrimin për të plotësuar kërkesat e arsyeshme për akses dhe interkoneksion, si dhe për përdorimin e elementeve të veçanta të rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese, në veçanti, në ato raste kur AKEP-i vlereson se nga refuzimi i aksesit ose nga termat e paarsyeshme, pengohet konkurrenca e qendrueshme në tregun e pakicës, apo kur dëmtohen interesat e përdoruesve fundorë”*
- Ky percaktim nënkupton se, nëse në një treg përkates nuk ekzistojnë këto kondita ligjore, AKEP, nuk vendos këte detyrim, si dhe bazuar në konkluzionet e analizës së tregut përkatës për mos përfshirjen e trafikut ndërkombetar hyrës në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin celular, gjë e cila nuk pengon konkurrencën e qendrueshme në tregun e pakicës dhe nuk dëmtohen interesat e përdoruesve fundore, rezulton se vendimi i AKEP-it i ankimuar sa më sipër, është i drejtë dhe i bazuar ligjërisht.
- d. AKEP me Vendimin nr.1739, datë 20.12.2011, ka percaktuar se tarifa e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin AMC është objekt i negociatave komerciale duke filluar nga 1.02.2012, dhe Vendimi nr.2119, date 4.07.2012, ka percaktuar heqjen e detyrimeve ex-ante për AMC për dhënie aksesit për këtë shërbim, duke filluar nga 1.09.2012.
- e. Nga shqyrtimi i informacionit të sjellë nga Albtelecom me shkresën nr.3944/2 prot., datë 4.09.2012, AKEP vëren se Albtelecom ka rënë dakort dhe ka nënshkruar dy amendime të MI me AMC për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin AMC. Pra palët kanë gjetur interes komercial të përbashkët për shërbimin e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin AMC. Ndërkohë informacioni i përcjellë evidenton edhe vendimet dhe ndërhyrjet e AKEP në vitin 2010 për këtë ceshtje dhe rastet e mosmarrveshjeve midis Albtelecom dhe AMC. Ndërkohë marrveshjet e Albtelecom me operatorët ndërkombëtarë evidentojnë faktin se këto marrëveshje janë komerciale dhe tarifat e terminimit janë objekt i rishikimeve të vazhdueshme/periodike, percaktim që AKEP ka marrë vendim ta implementojë dhe në ofertat referencë të operatorëve në Shqipëri.
- f. Për sa më sipër, argumentat dhe informacionet e paraqitura nga Albtelecom me shkresat nr. 3944 prot., datë 06.08.2012 dhe nr.3944/2 prot., datë 4.09.2012, nuk cmohen nga AKEP si të mjaftueshme dhe të mbështetura për të iniciuar ndryshimin e qëndrimit rregullator të AKEP në lidhje me aktin e nxjerrë prej tij, Vendimin nr.2119, datë 4.07.2012, dhe të detyrimeve ex-ante të percaktuara në këtë vendim.

¹ As for calls originated from abroad, termination rates are not regulated in most countries (Croatia, Montenegro, Albania, Macedonia, Turkey Serbia and Kosovo), and are defined by commercial agreement (confidential).

12. Aktet e nxjerra nga AKEP-i janë nxjerrë në zbatim të kompetencave ligjore dhe në bazë dhe në zbatim të ligjit material nr. 9918, duke përmbushur detyrimin kushtetues të sanksionuar në nenin 118 të Kushtetutës.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 135 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S :

1. Rëzimin e ankimit administrativ të Albtelecom sh.a dhe lënien në fuqi të Vendimit nr. 2119 datë 04.07.2012 “Për përcaktimin e sipërmarrësit Albanian Mobile Communications Sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese”;
2. Të njoftohet Albtelecom sh.a për zbatimin e këtij Vendimi;
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE